Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ me cilësinë \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj se kam në proces dhe/ose jam shpallur fitues për kontratat e mëposhtme:

<b>Nr.</b>	<b>Autoriteti kontraktor</b>	<b>Objekti i procedurës se prokurimi/kontratës</b>	<b>Vlera e shpallur fituese</b>

**Data e dorëzimit të deklaratës** \_\_\_\_\_

**Përfaqësuesi i ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**Vula**

**Shënim:** Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të plotësojë këtë deklaratë.

---

<sup>4</sup> Kjo deklarate ka si qëllim plotësimin e kriterit ligjor që operatori ekonomik brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nënkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura dhe/ose është shpallur fitues, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent

## **1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT**

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

**Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.**

**Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.**

**Nëçdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.**

**Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:**

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

## 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1 ose Shtojcës 2 (në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburante, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje);*
- b. Deklarate për paraqitje oferte të pavaruar sipas Shtojcës 1/1;*
- c. Sigurimine ofertës, (nëse është zbatueshme) sipas Shtojcës 4;*
- ç. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 6;*
- d. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;*
- dh. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 8/1;*
- e. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

### 2.1. Kapaciteti ligjor/profesionali operatorëve ekonomikë:

Permbushja e të gjitha kriterëve të përgjithshme. Objekti i verprimtarisë së operatorit ekonomik, sipas regjistrimit tregtar të QKB, duhet të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.

### 2.2 Per kapacitetin ekonomik dhe financiar:

- a) Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të certifikuara të bilanceve të 3 (tri) viteve të fundit ushtrimore (2017, 2018, 2019), të paraqitura në autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar.
- b) Kopje të deklaramentit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit ushtrimore (2017, 2018, 2019) lëshuar nga autoriteti përkatës, vlera mesatare e së cilës duhet të jetë jo më e vogël se 50% e vlerës së fondit limit perkatesisht: \_\_8 907 250 \_ lekë pa TVSH.
- c) Vërtetimin për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2018-2019-2020. Operatorët ekonomikë, duhet të paraqesin vërtetimin për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2018-2019 edhe për vendet e tjera të ushtrimit të aktivitetit, sipas ekstraktit të Qendres Kombëtare të Regjistrimit.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKR.

- d) Një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përben shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, me përjashtim të rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike,

te konfirmuara ne vertetimin e leshuar nga furnizuesi jane ne proces ankimimi ne gjykate ( *Ne rast te bashkimit te operatoreve cdo anetar i grupit duhet te pareqese kete vertetim*).

### 2.3 Kapaciteti teknik:

1. Licensa e shoqerise te kete kategorite e punimeve si vijon: NP-1B, NP-2B, NP-3/B, NP-4/A, NP-12/A, NS-1/B, NS-2/B, NS-4/A, NS-8/A NS-14/A, NS-18/A, NS-19A.

*Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.*

2. Kualifikimet dhe eksperiencia e personelit kryesor si Drejtues Teknik ne Licencen e Shoqerise te cilet do te realizoje zbatimin e objektit, te vertetuara per secilin punonjes me diplome, kontrate pune te vlefshme, Libreze pune. Shoqeria te kete ne stafin drejtues teknik ne license te cilet te figurojne në listpagesat e shoqërisë përtë paktën **12 (dymbëdhjete) muajt e fundit**, nje inxhinier ndertimi, nje inxhinier hidroteknik, nje inxhinier mjedisi, nje inxhinier mekanik, nje inxhinier elektrik, nje inxhinier topograf, nje inxhinier gjeolog, arkitekt me licence projektimi.
3. Kandidatiofertesduhettë përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklaroje se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqeruar me dokumentacionin e mëposhtme:
  - a) Libreze pune (përkatëse)
  - b) CV përkatëse
  - c) Kontratë pune e vlefshme noteriale (përkatëse)
  - d) Diplomë
4. Shoqeria duhet te kete ne personelin e saj **1 (nje) Ekspert Mjedisor**, per hartimin e raporteve te vleresimit dhe ndikimit ne mjedis dhe per te kryer auditimin mjedisor, hartimin e ekspertizave per probleme mjedisore dhe thirrjen si ekspert per te vleresuar nje raport vlersimit te ndikimit ne mjedis ose rezultatet e nje auditimi. Shoqeruar me dokumentacionin perkates ligjoro-profesional, si Diplome, Certifikaten Mjedisore leshuar nga Ministria Mjedisit, kontraten noteriale te punes, i cilitë rezultojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën **6 (gjashte) muajt e fundit** (*Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të ketë pjesë të stafit 1 (një) mjek të përgjithshëm*).
5. Operatori ekonomik ofertes duhet të ketë **1 (një) mjek të përgjithshëm** të punësuar dhe të rezultojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën **6 (gjashte) muajt e fundit**. Kjo të vërtetohet me paraqitjen e dokumenteve: kontratë pune të vlefshme, Urdhër Mjeku, CV, librezë pune, diplomën përkatëse. (*Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të ketë pjesë të stafit 1 (një) mjek të përgjithshëm*).

6. Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se ka pjesë të stafit të shoqërisë dy persona që përmbushin kriteret për të qenë **Pergjegjes/coordinator për realizimin e punimeve në fushën e sigurisë dhe të shëndeti tjetër realizimi të punimeve**, i cili duhet të jetë i pajisur me certifikatë/dëshmi trajnimi (Pergjegjes/kordinator për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë) që tregon pjesëmarrjen e tij në kurse specifike për sigurinë, të organizuara nga subjekte të njohura publike ose private, sipas kërkesave të ligjit nr. 10237 date 18.02.2010 “Per sigurine dhe shendetin ne pune” dhe V.K.M. nr. 312, date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”. Kjo të vërtetohet me paraqitjen e dokumenteve: kontratë pune të vlefshme, certifikaten e ekspertit, CV, librezë pune, diplomën përkatëse dhe të rezultojë në listëpagesat e shoqërisë **6 (gjashtë)** muajt e fundit. (Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimi tduhet të ketë pjesë të stafit 1 (një) pergjegjes per sigurine).
7. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë **1 (një) “Ekspert per Auditim energjie”** të punësuar dhe të rezultojë në listëpagesat e shoqërisë **6 (gjashtë)** muajt e fundit. Kjo të vërtetohet me paraqitjen e dokumenteve: kontratë pune të vlefshme, certifikaten e ekspertit, CV, librezë pune, diplomën përkatëse
8. Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij, nje person te certifikuar per **Ndihmen e pare dhe ndërhyrje ndaj emergjencave**, i cili duhet të figurojë në listepagese e shoqërisë **6 (gjashtë)** muajt e fundit.
9. Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij, nje person te certifikuar **Pergjegjes per sigurine dhe higjenen ne kantieret e perkohshme te ndertimit**, i cili duhet të figurojë në listepagese e shoqërisë **6 (gjashtë)** muajt e fundit .
10. Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij, nje person te certifikuar (inxhinier mjedisi ose staf me kualifikim te ngjashëm) si **"Pergjegjës për dëmet në mjedis"** gjatë kryerjes së veprimtarisë, në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” me eksperiencë pune jo më pak se 3 vjet, i cili duhet të figurojë në listepagese e shoqërisë **6 (gjashtë)** muajt e fundit .
11. Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij, nje person te certifikuar **Pergjegjes per vleresimin e risqeve ne kantier**, i cili duhet të figurojë në listepagese e shoqërisë **6 (gjashtë)** muajt e fundit .
12. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve, simëposhtë:
  - 3 (tre) elektrikist
  - 2 (dy) saldator
  - 2 (dy) teknik( ndërtim, topograf, elektrik, gjeondertim )
  - 4 (kater) manovrator
  - 3 (tre) pllakashtrues
  - 5 (pese) karpentier

## Dokumenta Standarde të Tenderit

- 3 (tre) bojaxhi
- 2 (dy) hidraulik
- 8 Specialist Ndertimi
- 3 (tre) hekurkthyes
- 2 (dy) punonjes gipsi
- 2 (dy) punonjes izolimi
- 5 (pese) shofer
- 5 (pese) punonjes ne lartesi

- Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme; deshmite e kualifikimit te sigurimit teknik, (tëvlefshme)si dhe te figurojne ne listepagesat e shoqërisë për të paktën6 (gjashte)muajt e fundit.

-Për punonjësi tTeknik Ndertimi duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme; diplomat e shkolles kualifikimit, deshmite e kualifikimit te sigurimi t teknik, (tëvlefshme),librezat e punes si dhe te figurojne ne listepagesat e shoqërisë për të paktën6 (gjashte) muajt e fundit.

-Për punonjësit e punimeve ne lartesi duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme; deshmite e kualifikimit, (tëvlefshme), librezat e punes si dhe te figurojne ne listepagesat e shoqërisë për të paktën 6 (gjashte) muajt e fundit.

-Për punonjësit manovrator duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme; deshmite e kualifikimit te sigurimit teknik, (tëvlefshme), deshmite e Aftesise profesionale nga DPSHTRR si dhe te figurojne ne listepagesat e shoqërisë për të paktën6 (gjashte) muajt e fundit.

13. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Licencë lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për grumbullim dhe transportim të mbetjeve që kanë ndikim në mjedis (Kodi III.2.B) ose kontrate sherbimi me Shoqeri qe e ofron kete sherbim.
14. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Licencë lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për “Sherbime ekspertize dhe/oseprofesionale te mbrojtjes civile” (Kodi I.2.A).
15. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Licencë lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për “Sherbimenderhyresehigjeno- shndetesore” (Kodi II.8.B).

16. Një punësim mesatar i të paktën **70 (shtatedhjete )** personave, për periudhën **Shkurt 2020-Korrik 2020** të vërtetuar me;

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; per periudhen **Shkurt 2020-Korrik 2020**.
- List pagesat e punonjesve sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per periudhen **Shkurt 2020-Korrik 2020**, shoqëruar me formularet e deklarimit te pagesave për sigurimet shoqërore dhe shendetesore si dhe mandat pagesat ne banke.

17. Numri dhe lloji i mjeteve dhe paisjeve ne pronesi/qera:(Shtojca 9).

Nr	Lloji i Makinerive	Statusi	Sasia
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi	në pronësi ose me qira	Copë 4

Dokumenta Standarde të Tenderit

	20 ton		
2	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10-20 ton	në pronësi ose me qira	Copë 4
3	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 5 -10 ton	në pronësi ose me qira	Copë 2
4	Kamioncine me kapacitet mbajtës deri ne 3.5 ton	në pronësi ose me qira	Cope 4
5	Mjete germimi me goma/ fadroma	në pronësi ose me qira	Copë 2
6	Autovinc	në pronësi ose me qira	Cope 2
7	Autobetoniere	në pronësi ose me qira	Cope 3
10	Motogjenerator / Gjenerator	në pronësi ose me qira	Copë 3
12	Eskavator me zinxhir	në pronësi ose me qira	Cope 5
3	Eskavator me goma	në pronësi ose me qira	Cope 2
14	Sharre asfalti	në pronësi ose me qira	Cope 1
15	Saldatrice / motosaldatrice	në pronësi ose me qira	Cope 4
16	Minieskavator	në pronësi ose me qira	Cope 2
17	Minifadrome	në pronësi ose me qira	Cope 1
18	Deflektometer ose pjaster dinamike per matjen e ngjeshjes se shtresave rrugore	në pronësi ose me qira	Cope 1
19	Pajisje per hekurkthyes (tranxhe/elektrobango	në pronësi ose me qira	Cope 1
20	Rulngjeshes	në pronësi ose me qira	Cope 2
21	Rul me kompresor	në pronësi ose me qira	Cope 2
22	Kontenier Stacioner (zyre ne objekt)	në pronësi ose me qira	Cope 2
23	Fabrike betoni e pajisur me leje mjedisore, dhe Licensen e QKL, ose kontrate noteriale furnizimi per objektin ne fjale nga nje Subjekt qe disponon fabrike prodhimi materiale betoni shoqeruar me te gjithë dokumentacionin perkates ligjoro-profesional (Leje Mjedisore, Leje Shfrytezimi, Licencen nga QKL	në pronësi / ose kontrate furnizimi	Cope 1
24	Çekicpneumatik per thyerjen e betoneve	Në pronësi ose me qera	Cope 1
25	Kompresorajri	Në pronësi ose me qera	Cope 1
26	Fabrike per prodhimin e materialeve inerte, te pajisur me dokumentacionin ligjor perkates, dhe Licensen e QKL /kategoria B, ose kontrate noteriale furnizimi per objektin ne fjale nga nje Subjekt qe disponon fabrike prodhimi materiale inerte shoqeruar me te gjithë dokumentacionin perkates ligjoro-profesional (Leje Mjedisore, Leje Shfrytezimi, Licencen nga QKL	në pronësi / ose kontrate furnizimi	Cope 1
27	Depozite uji 5000 lt	Në pronësi ose me qera	Cope 2
28	Autorimorkiator mjetesh	Në pronësi ose me qera	Cope 1
29	Autobote uji	Në pronësi ose me qera	Cope 2
30	Pompe uji per pastrim	Në pronësi ose me qera	Cope 2
31	Makineri Prerese hekuri	Në pronësi ose me qera	Cope 2
32	Pompe suvatimi	Në pronësi ose me qera	Cope 2

## Dokumenta Standarde të Tenderit

33	<i>Tokmak per ngjeshje</i>	Në pronësi ose me qera	<i>Cope 2</i>
34	<i>Matrapik</i>	Në pronësi ose me qera	<i>Copë 3</i>
35.	<i>Vinc ngjites karel</i>	Në pronësi ose me qera	<i>Cope 2</i>
36	<i>Vinc kulle 5 ton</i>	Në pronësi ose me qera	<i>Cope 1</i>
37	<i>Termometer per matje togezimi</i>	Në pronësi ose me qera	<i>Cope 1</i>
38	<i>Vibrator betoni</i>	Në pronësi ose me qera	<i>Cope 4</i>
39	<i>Betoniere 0.5m3</i>	Në pronësi ose me qera	<i>Cope 4</i>
40	<i>Instrument nivelues</i>	Në pronësi ose me qera	<i>Cope 1</i>

Te paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 60 copë
  - Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 8 copë
  - Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 6 copë
  - Kulle ndricimi – 2 cope
  - Komplet i ndimës së shpejtë minimumi 30 copë
  - Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 50copë
- a) *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit; b) leje qarkullimi; c) çertifikaten e kontrollit teknik; d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); f) çertifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme), g) license e shoqerise per transport. Për mjetet e siguruara me qera duhet të paraqitet: a) dokumenti qe verteton regjistrimin e tij; b) leje qarkullimi; c) çertifikaten e kontrollit teknik, d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); f) çertifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Mjetet të shoqerohen me kontraten perkatese te qerases/furnizimit, e vlefshme per te gjithe periudhen e realizimit te kontrates, ku te percaktoret objekti i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve te tjera duhet te jene aktet e ç'doganimit ose faturat tatimore te blerjes.*
- b) *Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i prokurimi ne fjalet si dhe afati i saj.*
- c) *Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*
- d) *Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 9. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese). Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk jane te deklaruara ne procedurat te shpallura fitues nga autoriteti kontraktot. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku te deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi). ( ne rast se ofertuesi eshte bashkim operatoreve, çdo anetar i ketij bashkimi duhet te paraqese kete dokument)*

**18. Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:**

**Përvojë e suksesshmenë realizimin e të paktën:**



## Dokumenta Standarde të Tenderit

- Punë të ngjashme për një objekt të vetëm **jo me te vogel se 50% e vlerësë** përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: **\_8 907 250 \_** lekë pa TVSH, të realizuar gjatë tri viteve të fundit.
- punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit është në një vlerë sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: **\_35 629 000\_** lekë pa TVSH.

Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

### **Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:**

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike,operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
  1. Deklaratën sipas shtojcës Nr. 8, shoqëruar me:
  2. Kontratë
  3. Situacionin përfundimtar;
  4. Aktin e kolaudimit;
  5. Çertifikaten e marrjes ne dorezim.
  6. Fatura tatimore per cdo situacion punimesh.
- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
  1. Deklaratën sipas shtojcës Nr. 8, shoqëruar me:
  2. Kontrate;
  3. Situacionin përfundimtar;
  4. Akt kolaudimi objekti;
  5. Çertifikaten e marrjes ne dorezim te objektit;
  6. Fatura tatimore per cdo situacion punimesh.

*Pika 12/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 12/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

**18.**Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me çertifikata cilësie të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit i vendit ku është akredituar ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Shqipëri (DPA). Çertifikatat që kërkohen duhet të jenë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit:

- Shoqëria duhet të paraqesë Çertifikatë të cilësisë së punimeve **ISO 9001- 2015 (e vlefshme)**. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtari grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).
- Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatë **ISO 14001-2015 (e vlefshme)**.(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtari grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).

## Dokumenta Standarde të Tenderit

- Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatë **OHSAS 18001-2007 ose 45001-2018 (Ekuivalente, te vlefshme)**. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtari grupit duhet të paraqesë Çertifikatën OHSAS).
- Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatë **ISO 39001 -2012 (e vlefshme)**. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtari grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).
- Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatë **PASS 99:2012 (e vlefshme)**. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtari grupit duhet të paraqesë Çertifikatën PASS).
- Operatori ekonomik duhet të paraqes certefikate **ISO 50001 : 2011** per menaxhimin e energjise(**e vlefshme**).
- Operatori ekonomik duhet të paraqes certefikate **ISO 3834-2 : 2006** per shkrirjen e metaleve (saldimeve) (**e vlefshme**). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtari grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).
- Operatori ekonomik duhet të paraqes certefikate **ISO 27001 : 2013** per menaxhimin e sigurise se informacionit(**e vlefshme**). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtari grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).
- Operatori ekonomik duhet të paraqes certefikate **ISO 8000 : 2014 (e vlefshme)**. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtari grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).
- Operatori ekonomik duhet të paraqes certefikate **ISO 20000-1 : 2011 (e vlefshme)**. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtari grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).

Çertifikatat të jenë në gjuhen shqipe ose te përkthyer dhe të noterizuara.

- *Certifikatat ISO duhet të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*
- **Ne rastet e bashkimit** te operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te paraqese keto certifikata, ISO sipas natyrës së punimeve që marrin përsipër ne aktmarrëveshjen e bashkepunimit ne raport me punimet qe do marrin persiper.

**(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, kandidatët/ofertuesit duhet t'i përmbahen VKM-së nr.914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik " si dhe te respektojne rigorozisht udhezimet e APP per operatoret ekonomike per rastin e bashkimit te operatoreve ne procedurat elektronike te prokurimit . Mos respektimi i udhezimeve te APP sjell skualifikim te operatorit.)**

\* **Shënim:** Janë të lutur të gjithë opërtat ekonomikë të interesuar për të marrë pjesë në procedurë të paraqesin dokumentacion vetëm në lidhje me kriteret e përcaktuara në DST dhe jo dokumentacion që nuk ka lidhje ose tejkalon kriteret e përcaktuara në DST, gjë që shkakton konfuzion dhe vonesa në procesin e vlerësimit.

## Dokumenta Standarde të Tenderit

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

### Shtojca 13

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)*

#### **PROJEKTI I ZBATIMIT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE**

**Përshkrimi i të dhënave teknike të punëve objekt prokurimi** të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

#### **KUJDES**

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Skicimet, Planimetritë e Objektit etj:

B/lidhur DST

Specifikimet Teknike të Materialeve:

B/lidhur DST

Grafiku i Punimeve:

B/lidhur DST

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

B/lidhur DST

**Shtojca 14**

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)*

**PREVENTIVAT E PUNIMEVE**

Pese segmente rrugore bashkengjitur DST

B/lidhur DST

**Shtojca 15**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

**NJOFTIM STANDART PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR<sup>5</sup>**

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar Z. /Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 Për Prokurimin Publik.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

---

---

---

---

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP-së.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt  
< **Emri** >

---

<sup>5</sup> Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

**Shtojca 16**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar Autoriteti Kontraktor* ]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

[Data\_\_\_\_\_]

Për: [ *Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues* ]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [ *Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës* ]

Publikime të mëparshme ( *nëse zbatohet* ): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët  oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_

*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_

*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

2. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

\* \* \*

## Dokumenta Standarde të Tenderit

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [\_\_\_\_\_]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

[Titullari i autoritetit kontraktor]





Dokumenta Standarde të Tenderit

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

2. \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_/Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

2. \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_/Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

Etj. \_\_\_\_\_

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

**[Titullari i autoritetit kontraktor]**

## Shtojca 18

### **KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS Punët – Procedura e Hapur**

#### **Neni 1: Qëllimi**

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Punëve të prokuruarra ne bazë të legjislacionit të prokurimit.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

#### **Neni 2: Përkufizime**

- 2.1 “Preventiv total” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotesuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.
- 2.2 “Preventiv per njesi” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njesi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.
- 2.3 “Afati i realizimit te punimeve” do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikon për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokurues.
- 2.4 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha

## Dokumenta Standarde të Tenderit

bashkangjitet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.

- 2.5 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.6 “Realizimi i punimeve” do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.
- 2.7 “Defekt” do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.
- 2.8 “Data e hyrjes” do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.
- 2.9 “Data e fillimit” është përfshirë në Të dhënat e kontratës. Ajo është data kur kontraktori do të fillojë punimet e ndertimit. Nëse kjo nuk realizohet, “data e fillimit” do të jetë dita në të cilën do të paguhet paradhenia.
- 2.10 “Pajisje” do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.
- 2.11 “Materiale” do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.
- 2.12 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.13 “Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.14 “Drejtues projekti” do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.
- 2.15 “Autoritet Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe që kontraktori punon objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.16 “Kantier” do të thotë vendi fizik i Punimeve.
- 2.17 “Raport i inspektimit të kantierit” do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.
- 2.18 “Nënkontraktues” do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.
- 2.19 “Kontraktor” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.
- 2.20 “Standarte Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si

rregulla, rregullore ose përkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

- 2.21 “Ngritja e kantierit” do të thotë punimet e ndertimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluar, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndërtimit.
- 2.22 “Punime” do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të përkufizuara në dokumentat e tenderit.

### **Neni 3: Hartimi i Kontratës**

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

### **Neni 4: Praktikrat e Korrupuara, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve**

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korrupuara. Veprimet e korrupuara përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në pregatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktori duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

### **Neni 5: Informacioni Konfidencial**

- 5.1 Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktori mund t’i japë nënkontraktorit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar që nënkontraktorin të zbatojë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, kontraktori duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë që premtion ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

### **Neni 6: Prona Intelektuale**

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruar nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t’i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t’i përdorë ato sipas gjykimit të tij.

- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose pregatitura nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

#### **Neni 7: Origjina e Materialeve**

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.
- 7.3 Për qëllime verifikimi "origjinë" do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, bashkuar ose prodhuar. materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e kontraktorit ose nënkontraktorit që furnizon me materiale.

#### **Neni 8: Vendimet e Drejtuesit të Projektit**

- 8.1 Drejtuesi i projektit do të vendosë për çështjet e kontratës midis kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor
- 8.2 Drejtuesi i Projektit mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij tek të tjerët përveç zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe konflikteve. Drejtuesi i projektit duhet të njoftojë kontraktorin për delegimet e bëra apo të revokuara.

#### **Neni 9: Komunikimi**

- 9.1 Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

#### **Neni 10: Bashkëpunimi në Kantier me të Tjerët**

- 10.1 Kontraktori duhet të bashkëpunojë dhe të ndajë kantierin me firma të tjera, autoritete publike, shërbimet publike dhe Autoritetin Kontraktor siç kërkohet dhe përkufizohet në Grafikon e realizimit të punimeve.

**Neni 11: Përgjegjësia e Autoritetit Kontraktor**

- 11.1 Autoriteti Kontraktor ka përgjegjësi të kompensojë kontraktorin për dëmtime të pajisjeve të kontraktorit deri në masën që lidhet me veprime me faj të Autoritetit Kontraktor ose të projekteve të Autoritetit Kontraktor me përjashtim të rastit kur keto të fundit, kishin gabime të dukshme që mund të ishin konstatuar lehtësisht nga kontraktuesi.

**Neni 12: Raporti i Inspektimit të Kantierit dhe Kushtet e Kantierit**

- 12.1 Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për konkluzionet ose interpretimet e bëra në raportin e inspektimit të kantierit.
- 12.2 Kontraktori pranon se i ka marrë të gjitha hapat e nevojshme për të verifikuar natyrën dhe vendin e Punimeve dhe se ka inspektuar dhe pajtohet me kushtet e përgjithshme dhe lokale që mund të ndikojnë në kryerjen ose koston e Punëve.

**Neni 13: Kontraktori që Kryen Punimet**

- 13.1 Kontraktori duhet të kryejë dhe mbarojë Punimet në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit.
- 13.2 Kontraktori nuk mban përgjegjësi për gabimet në projekt, të dhëna, planimetri ose aspekte të tjera të specifikimeve teknike, të dhëna nga Autoriteti Kontraktor, me përjashtim të rasteve kur gabimi ishte aq i dukshëm sa kontraktori duhet ta kishte vënë re dhe ta kishte reklamuar këtë të Autoriteti Kontraktor.
- 13.3 Kodet dhe standartet që do zbatohen do të jenë të shprehura në dokumentat e tenderit. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në zbatimin e kodeve ose standarteve, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pasi të jenë aprovuar nga Autoriteti Kontraktor.

**Neni 14: Ekzekutimi i Punimeve**

- 14.1 Kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë sapo ta lidhe atë dhe duhet t'i mbarojë Punët brenda Afatit të Mbarimit.

**Neni 15: Ngritja e Kantierit**

- 15.1 Kontraktori mban përgjegjësi për projektin e Ngritjes së Kantierit.
- 15.2 Kontraktori duhet të paraqesë të gjitha planet për Ngritjen e Kantierit tek drejtuesi i projektit për shqyrtimin dhe miratimin e tij.

**Neni 16: Sigurimi Teknik dhe Mjedisor**

- 16.1 Kontraktori do të mbajë përgjegjësi për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në kantier.

